

Udhëzimet shtesë për Strategjinë komunale për kthime

Në vijim të qarkullimit të dokumentit të Strategjisë komunale për kthime në muajin korrik, shumë komuna kanë filluar punën për zhvillimin e Strategjisë komunale për kthime. Kjo është në përputhje me planin për zbatimin e standardeve në Kosovë që në mënyrë të quartë kërkon nga komunat dhe ministritë të marrin përgjegjësitë për kthime për të gjitha komunitetet në përputhje me standartet e Evropës.

Shqyrtimi i gjysëmvjetorit të vitit 2005 do të përfshijë një vlerësim të punëve komunale lidhur me Strategjinë komunale për kthime. Pra, përparimi i gjerëtanishëm dallon nga komuna në komunë. Një numër i komunave tanimë i kanë nënshkruar strategjitet gjersa shumica e komunave tjera janë në etapat e ndryshme të zhvillimit. Megjithatë, disa kanë arritur një përparim shumë, shumë të vogël.

Qëllimi i këtij udhëzimi është që të ndihmojë mëtej ato komuna të cilat tanimë kanë filluar punën në këtë strategji, në krahasim me ato komuna të cilat nuk kanë filluar punën, në mënyrë që Strategjia komunale për kthime të mbetet një komponentë bazë për planin e zbatimit të standardeve në Kosovë, të cilin pritet se çdo komunë do ta zhillojë dhe zbatojë. Punësimi i zyrtarëve në shumë komuna duhet të ndihmojë që procesi i kësaj strategjie të lëvizë përpara. Zhvillimi i Strategjisë komunale për kthime duhet të jetë detyrë prioritare për zyrtarët e ri të punësuar për çështje të kthimit.

Përbajtja e Strategjisë komunale për kthime

Strategjia komunale për kthime ka për qëllim të shërbejë si kornizë për aktivitete të Grupit punues komunal gjatë vitit. Prandaj, sugjerohet që shefi i ekzekutivit të gjejë një plan zbatues për çdo aktivitet të propozuar në Strategjinë komunale për kthime, duke veçuar aktivitete kyçe dhe kornizën kohore dhe duke caktuar punët për drejtoratin përkatës ose autoritetin komunal. Shefi i ekzekutivit do të ndihmohet nga zyrtari komunal për kthime përkitazi me bakhërendimin dhe monitorim e këtyre aktiviteteve. Për më tepër, rekomandohet që shefi i ekzekutivit dhe (ose) zyrtari për kthime komunale të raportojnë rregullisht mbi statusin e planit zbatues për çdo veprim të propozuar në takimet e Grupit punues komunal.

Zhvillimi i Strategjisë komunale për kthime është pjesa bazë e standartit për kthime të qëndrueshme dhe, ashtu siç ka qenë e cekur më herët, ajo duhet të futet brenda një kontesti më të gjerë të arrijes së mbrojtjes më të madhe të të drejtave të të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë. Strategjia komunale për kthime ka qëllim të veçant që të

sigurojë se komunat punojnë drejtë krijimit të kushteve për kthime vullnetare të komuniteteve joshumicë. Gjersa të kthyerit me forcë, që nënkupton ata individë që janë riatthesuar me forcë në Kosovë, janë gjithashtu përgjegjësi e komunave, dhe mbështetja e këtij grapi është kryesisht e kufizuar me ndihmën humanitare dhe duhet të trajtohet jasht Grupit punues komunal dhe Jasht procesit të Strategjisë komunale për kthime.

Komunat duhet të përkujtohen se Strategjia komunale për kthime e nënshkruar është një dokument zyrtar publik. Prandaj, komunat këshillohen që t'i shmangën përdorimit të gjuhës nxitëse, kushtëzimin e kthimeve lidhur me zgjidhjen e çështjeve tjera, siç janë personat e zhdukur, mbështetja selektive e llojeve të kthimit, që do të thotë kthimet e organizuara përkundër kthimeve spontane, kthimeve rurale përkundër kthimeve urbane, meqë ato shkelin parimet dhe politikat e kthimit të cilat janë pajtuar nga IPVQ-të dhe UNMIK-u dhe të cilat kërkohen me Planin e zbatimit të standardeve.

Shqyrimi i Strategjisë komunale për kthime

Komunat inkurajohen me ngulm që të kyçen në një proces shqyrties për Strategjinë komunale për kthime të ngjashëm me procesin e ndërmarrë për konceptdokumentet për kthime. Projekti i Strategjisë komunale për kthime duhet të dërgohet nga kryetari i Kuvendit të Komunës, përmes kryesuesit ose kryesuesëve të Grupit punues komunal, për anëtarët e Grupit punues komunal. Anëtarëve të Grupit punues komunal duhet dhënë kohë adekuate për të dhënë kontribute dhe komente para nënshkrimit. Është në veçanti e rëndësishme që personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV) apo përfaqësuesit e tyre të kyçen në procesin e shqyrimit. Kryetari i Kuvendit Komunal, përmes shefit të ekzekutivit apo zyrtarit a zyrtarëve komunal për kthime, duhet të sigurojë që përfaqësuesit e PZHBV-ve, të cilit marrin pjesë në Grupin punues komunal, të kenë rast të shqyrtojnë dhe të kontribuojnë në projektstrategjinë komunale për kthime para nënshkrimit të saj. Projektstrategjia komunale për kthime duhet të diskutohet në Grupin komunal për kthime dhe vendimi përfundimtar për nënshkrimin e Strategjisë komunale për kthime duhet të arrihet me koncensus.

Siç është cekur më herët, komunat gjithashtu inkurajohen që të kërkojnë kontributin e krytarëve të Zyrave komunale për komunitete, zavendëskrytarëve, komisioneve të komuniteteve dhe komisioneve për ndërhyrje, si dhe të shfrytëzojnë përvojën e fituar të zyrtarëve në terren të UNHCR-it dhe zyrtarëve lokal për komunitete të UNMIK-ut dhe Njësisë rajonale për kthime gjatë zhvillimit të strategjisë.

Komunat mund gjithashtu të përcaktohen për shkëmbimin e ideve me njera-tjetren gjatë zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë. Njësitë rajonale për kthime të UNMIK-ut janë të gatshme të ndihmojnë takimet me kryetarët komunal, shefat e ekzekutivit dhe apo me zyrtarët komunal për kthime, brenda një rajoni të caktuar, për të shkëmbyer përvojat më të mira dhe të diskutojnë mënyrat për ta shtyrë procesin e zhvillimit të strategjisë përpëra në nivelin rajonal. Komunat në Kosovë më tej inkurajohen që të krijojnë lidhje me komunat e të zhvendosurve, duke shkëmbyer strategjitet komunale për kthime, të nënshkruara për qëllime të punës së përbashkët, për ta ndihmuar kthimin dhe (apo) për të shqyrta nevojat e personave të zhvendosur.

Nënshkrimi i Strategjisë komunale për kthime për vitin 2005

Shumë komuna nuk kanë filluar punën në Strategjinë komunale për kthime gjerë në fund të vitit, gjersa komunat tjera as që kanë filluar me zhvillimin e strategjisë. Strategjitetë e nënshkruara për vitin 2004 duhet të azhurnohen për vitin 2005, duhet të shqyrtohen nga anëtarët e Grupit punues komunal dhe të nënshkruhen më 31 dhjetor 2004, mu ashtu sikur është këshilluar më herët. Komunat të cilat nuk i kanë projektuar ende strategjitetë, duhet t'i zhvillojnë Strategjitetë komunale për kthime për vitin 2005 sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që ato të nënshkruhen më 31 dhjetor 2004. Pritet nga komunat të dorëzojnë Strategjinë të miratuar Komunale për Kthime tek niveli qendror në bazë të udhëzimeve të mëtejshme që do të jenë të gatshme.